

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**  
**DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI**  
**PROGRAMI: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT**



**PUNIMI I DIPLOMËS MASTER**

**Tema me titull:**

**Procesi i Vendimmarrjes gjatë Menaxhimit të Fermave në Sektorin e Hortikulturës**

**Udhëheqësi shkencor:**

**Prof. Ass. Dr. Njazi Bytyqi**

**Kandidatja:**

**Bsc. Rita Frrokaj**

**Prishtinë, Qershor, 2022**

## ABSTRAKT

Strukturat bujqësore në Kosovë vazhdon të dominohet nga prodhuesit/fermerët e vegjël, ku shumica dërrmuese e fermerëve kanë prona tokësore të vogla. Numri i përgjithshëm i fermerëve me prona më pak se 2 hektarë arrin në afro 78% dhe në të shumtën e rasteve parcelat e tokës janë të fragmentuara, gjë që e bën edhe më të vështirë zhvillimin e bujqësisë. Fermerët kosovarë përballen me probleme të shumta, si: Pronat e vogla dhe të fragmentuara të tokës bujqësore, që pengojnë fermerët të përdorin makineri efikase, aplikimin e inputeve, ujitjen dhe korrijen e prodhimeve dhe përfitimit nga marketingu i produkteve dhe blerja e inputeve bujqësore; Sasi të vogla të prodhimit, që rezultojnë në mundësi të kufizuara për marketing brenda dhe jashtë vendit; Produktiviteti i ulët për shkak të cilësisë së ulët të inputeve bujqësore (fara, fidane, plehra, pesticide etj.); Cilësia e ulët e prodhimit, që kufizon mundësitë për eksporte dhe përpunim vendor; Mungesa e qasjes në shërbimet këshillimore dhe teknologjitë e reja.

Zakonisht fermerët merren me kultivimin e shumë kulturave bujqësore me sipërfaqe të vogla dhe nuk specializohen në prodhimin e një numri të vogël të kulturave bujqësore për të shmangur monokulturën dhe për të siguruar të ardhura më të mira. Pra, qëllimi kryesor i studimit/hulumtimit ka qenë që përmes shqyrtimit të literaturës relevante dhe anketës me fermerë të analizojmë vendimet e rëndësishme të tyre, që janë ndërmarrë në dhjetë vitet e fundit, vendime të cilat kanë rezultuar në rritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore në sektorin e hortikulturës, rritjen e punësimit, rritjen e dukshme të eksporteve në vendet të rajonit dhe BE-së dhe në përgjithësi rritjen e aftësisë konkurruese. Për të arritur deri të rezultati i dëshiruar është përdorur metodologjia e duhur, duke shqyrtuar literaturën relevante (studime, raporte, ueb faqe, etj.) dhe përmes anketimit të tridhjetë fermerëve dhe ndërmarrjeve bujqësore në sektorin e hortikulturës. Si rezultat i hulumtimit kemi ardhur në përfundim se fermerët duhet të specializohen në kultura të ndryshme bujqësore, të rrisin sipërfaqet e tyre, të aplikojnë inpute bujqësore cilësore (farëra, fidanë, plehra, pesticide, etj.) dhe mekanizëm bujqësorë efikas, si dhe të kenë qasje të vazhdueshme në shërbime këshillimore dhe teknologji të reja.

**Fjalët kyçe: Fermerë, vendimmarrje, inpute bujqësore, menaxhim.**